



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**  
**KËSHILLI DREJTUES**

Nr. Prot. \_\_\_\_\_

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2022

**VENDIM**

**Nr. 31, datë 31.10.2022**

**MBI**  
**MIRATIMIN E PLANIT TË VAZHDIMËSISË**  
**SË VEPRIMTARISË TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**

Në bazë dhe në zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 8, pika 2, shkronja “k” të Statutit të Agjencisë të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të “Planit Strategjik të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitet 2021-2023”, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 5, datë 26.02.2021, të nenit 5, pika 2, shkronja “a” dhe shkronja “b” të Rregullores “Për administrimin e rreziqeve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 32, datë 23.10.2015, si dhe të nenit 18, pika 2 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë Planin e vazhdimësisë së veprimtarisë të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen njësitë organizative të Agjencisë për zbatimin e këtij vendimi.





3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Donald Duraj

Kryetar

Shqipe Malaj

Sekretare

